

Emertimi dhe Forma Ligjore

“Ujesjelles Ura Vajguore”

Shoqeri anonime

NIPT-I

K32803022R

Adresa e Selise

LAGJA “18 TETORI” Ura Vajguore

Data e krijimit

22.04.2003

Nr. i Rregjistrimit Tregtar

29588

Veprimtaria kryesore

**Prodhimi dhe furnizimi me uje te
pijshem .**

PASQYRAT FINANCIARE

Viti 2014

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2014 Deri 31.12.2014

DATA E MBYLLJES SE PASQYRAVE FINANCIARE 24.03.2015

PASQYRAT FINANCIARE JANE INDIVIDUALE INDIVIDUALE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE KONSOLIDUARA _____

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE SHPREHURA NE LEKE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE RRUMBULLAKOSURA NE 0 LEKE

Ekspert kontabël i regjistruar

Dhimo Dundo

Liçenca profesionale

Nr.8, date 11.01.2000

Adresa: "Shtëpia e ushtarakeve", Kat.3/2, Berat

Cel: 069 20 99 203

Tel/fax: (032) 238360

E-mail: dhimo_dundo@hotmail.com

AS-Audit Services sh.p.k

Adresa: Rr. "KOSOVAREVE", ND.35, H.2, Ap.7

Njesia Bashkiake Nr.5, Tiranë

(Prane Diges se Liqenit Artificial)

Cel: 069 20 99 204

Tel/fax: (04) 2 430 084

E-mail: as-auditservices@hotmail.com

Raport i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e shoqërise "Ujësllës Ura Vajgurore" sh.a

Adresa selisë: Ura Vajgurore.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të shoqërisë "Ujësllës Ura Vajgurore" sh.a, të cilat përfshijnë bilancin kontabël të datës 31 Dhjetor 2014 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e fluksit të parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin mbyllur në këtë datë, një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël, si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Shqipëtare të Raportimit Financiar (SKK-të), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur siguri dhe arsyeshmëri për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrethimeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrethimeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Baza për Opinion me Rezerve

1. Në shënimin nr.4 të pasqyrave financiare, shoqëria ka pasqyruar në bilanc me 31 dhjetor 2014 dhe 2013 llogari të arkëtueshme respektivisht në shumën 8.813.380 lekë dhe 10.905.557 lekë. Bazuar në auditimin tonë, ne identifikuar që shumë nga tepricat e llogarive të klienteve familjarë, enteve buxhetore dhe biznese private janë të vjetra dhe kanë tregues për zhvleresim, por megjithatë shoqëria nuk ka krijuar asnjë provizion për zhvleresimin e tyre në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Për më tepër, ne nuk siguruam të dhëna dhe informacione të mjaftueshme për të vlerësuar masën e zhvlerësimit dhe rrjedhimisht nuk ishim në gjëndje të siguroheshim mbi vlerën e arkëtueshme në fund të ushtrimit.
2. Siç paraqitet në shënimin nr.7 të pasqyrave financiare, vlera neto e aktiveve afatgjata materiale më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është respektivisht 19.524.935 lekë dhe 20.772.624 lekë. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit kërkojnë që në çdo datë raportimi aktivet afatgjata materiale të rishikohen për zhvleresim sa herë që ngjarje apo ndryshime të rrethanave tregojnë që shumat neto të një aktivi mund të mos jenë të rikuperueshme. Shoqëria nuk ka përgatitur një vlerësim të detajuar të aktiveve afatgjata materiale që ka përdorim, dhe për këtë arsye, ne nuk ishim në gjëndje të siguroheshim për rikupershëmërinë e shumës së regjistruar si aktive afatgjata materiale në bilanc më 31 dhjetor 2014.

Opinion

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes të përshkruar në paragrafin e bazës për opinion me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë "Ujësjetës Ura Vajguore" sh.a, më datën 31 Dhjetor 2014, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur, në përputhje me Standardet Shqipëtare të Raportimit Financiar (SKK-të).

Ekspert Kontabël të Regjistruar

Afrim Suli

Berat, më 06 Maj 2015



Dhimo Dundo



“Ujësja e Ura Vajgurore” sh.a

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e bilancit kontabel me 31.12.2014

	<u>ZERI I BILANCIT</u>	She nime	Viti ushtrimor 2014	Ushtrimi paraardhes 2013
A	AKTIVET			
I	Aktivët Afatshkurtër			
1	Mjete monetare	3	1,003,037	191,249
2	Derivative dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim		0	0
(i)	-Derivatet		0	0
(ii)	-Aktivët e mbajtura për tregtim		0	0
	Totali 2		0	0
3	Aktive të tjera financiare afatshkurtra		10,607,116	11,407,076
(i)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	4	8,813,380	10,905,557
(ii)	Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5	1,793,736	501,519
(iii)	Instrumente të tjera borxhi		0	0
(iv)	Investime të tjera financiare		0	0
	Totali 3		10,607,116	11,407,076
4	Inventari	6	414,032	388,620
(i)	Lëndët e para	6	414,032	388,620
(ii)	Prodhim në proces	6	0	0
(iii)	Produkte të gatshme	6	0	0
(iv)	Mallra për rishitje	6	0	0
(v)	Parapagesat për furnizime	6	0	0
	Totali 4		414,032	388,620
5	Aktivët biologjike afatshkurtra		0	0
6	Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje		0	0
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		0	0
	Totali i aktiveve afatshkurtra (I)		12,024,185	11,986,945
II	Aktivët afatgjatë		0	0
1	Investimet financiare afatgjatë		0	0
(i)	Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		0	0
(ii)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje		0	0
(iii)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë		0	0
(iv)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme afatgjatë		0	0
	Totali 1.		0	0
2	Aktive afatgjatë materiale	7	19,524,935	20,772,624
(i)	Toka	7	3,675,840	3,675,840
(ii)	Ndërtesa	7	13,637,986	14,355,775
(iii)	Makineri dhe pajisje	7	2,018,269	2,422,915
(iv)	Aktive të tjera afatgjatë materiale (me vl.kontab.)		192,840	318,094
	Totali 2		19,524,935	20,772,624
3	Aktivët Biologjike afatgjatë		0	0
4	Aktivët afatgjatë jomateriale		0	0
(i)	Emri i mire		0	0
(ii)	Shpenzimet e zhvillimit		0	0
(iii)	Aktive të tjera afatgjatë jomateriale		0	0
	Totali 4		0	0
5	Kapital aksionar i papaguar		0	0
6	Aktive të tjera afatgjatë		0	0
	Totali i aktiveve Afatgjatë (II)		19,524,935	20,772,624
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		31,549,120	32,759,569

“Ujësja Ura Vajgurore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

B	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	Detyrimet Afatshkurtëra			
1	Derivativët		0	0
2	Huamarrjet		0	0
(i)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra		0	0
(ii)	Kthimet/ripagesat e huave afatgjata		0	0
(iii)	Bono të konvertueshme		0	0
	Totali 2		0	0
3	Huat dhe parapagimet	8	23,302,445	17,908,276
(i)	Të pagueshme ndaj furnitorëve	8	19,846,540	13,867,116
(ii)	Të pagueshme ndaj punonjësve	8	1,343,305	1,789,257
(iii)	Detyrime tatimore	8	818,332	769,547
(iv)	Hua të tjera	8	1,294,268	1,482,356
(v)	Parapagimet e arkëtuara	8	0	0
	Totali 3		23,302,445	17,908,276
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		0	0
5	Provizionet afatshkurtra		0	0
	Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		23,302,445	17,908,276
II	Detyrime afatgjata		0	0
1	Huat afatgjata		0	0
(i)	Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare		0	0
(ii)	Bonot e konvertueshme		0	0
	Totali 1		0	0
2	Huamarrje të tjera afatgjata		0	0
3	Provizionet afatgjata		0	0
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra	9	0	2,531,029
	Totali i detyrimeve afatgjata (II)		0	2,531,029
	Totali i detyrimeve (I+II)		23,302,445	20,439,305
III	Kapitali		0	0
1	Aksionet e pakicës		0	0
	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë			
2	mëmë		0	0
3	Kapitali aksionar	10	4,066,002	4,066,002
4	Primi i aksionit		3,675,840	3,675,840
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		0	0
6	Rezerva statusore		0	0
7	Rezerva ligjore	10	199,208	199,208
8	Rezerva të tjera	10	4,379,217	3,651,150
9	Fitimet e pashpërndara	11.7	0	(883,602)
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	11.7	(4,073,592)	1,611,668
	Totali i kapitalit (III)		8,246,675	12,320,267
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)		31,549,120	32,759,571

“Ujësjetës Ura Vajgurore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguse

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të Periudhës 1 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor 2014

(Bazuar në klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres)

		Shëni me	Viti ushtrimor 2014	Ushtrimi paraardhes 2013
1	Shitjet neto	11.1	16,638,054	16,731,220
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	11.2	7,683,470	11,508,811
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces		0	0
4	Materialet e konsumuara	11.3	(10,930,228)	(7,669,150)
5	Kosto e punës	11.4	(13,074,207)	(13,290,719)
	Pagat		(11,202,953)	(11,388,577)
	Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(1,871,254)	(1,902,142)
6	Amortizimi dhe zhvleresimet	8	(1,268,041)	(1,148,493)
7	Shpenzime të tjera	11.5	(4,781,031)	(5,554,266)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4-7)		(30,053,507)	(27,662,628)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)		(5,731,983)	577,403
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		0	0
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		0	0
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		0	0
12,1	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		0	0
12,2	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	11.6	0	15,104
12,3	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi		0	0
12,4	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare		1,658,391	1,200,000
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)		1,658,391	1,215,104
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9+10+11+12+/-13)		(4,073,592)	1,792,507
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	11.7	0	180,839
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	11.7	(4,073,592)	1,611,668
17	Elementet e pasqyrave të konsoliduara			

“Ujësja e Ura Vajguore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e Fluksit monetar për Periudhën 1 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor 2014

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	She nime	Viti ushtrimor 2014	Ushtrimi paraardhes 2013
Fluksi i monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit	11.7	(4,073,592)	1,792,507
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin	7	1,265,991	1,094,752
Humbje nga kembimet valutore			
Të ardhura nga investimet		0	0
Shpenzime per interesa		0	0
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti si dhe e kërkesave të tjera	3,4	799,960	642,738
Rritje/renie në tepricën e inventarit	6	(25,412)	516,052
Rritje/renie në tepricën e detyrimeve për të paguar nga aktiviteti	8	5,394,169	(1,504,547)
Mjetet monetare të perfituara nga aktivitetet		3,361,116	2,541,502
Interesi i paguar		0	0
Tatimfitimi i paguar	11.7	0	(180,839)
Rritje/renie e parapagimeve dhe e shpenzimeve të shtyra		0	0
<u>Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit</u>		<u>3,361,116</u>	<u>2,360,663</u>
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerje e shoqërisë së kontrolluar ____ minus parate e arkëtuara			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	7	(18,300)	(970,573)
Të ardhura nga shitja e paisjeve		0	0
Interesi i arkëtuar			
Dividendet e arkëtuara			
<u>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese</u>		<u>(18,300)</u>	<u>(970,573)</u>
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner			
Të ardhura nga huamarrje afatgjata		0	0
Pagesa e detyrimeve të qirase financiare		0	0
Dividendet e paguar			
Grante afatgjata		(2,531,029)	(2,500,000)
<u>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare</u>		<u>(2,531,029)</u>	<u>(2,500,000)</u>
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		811,788	(1,109,910)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		191,249	1,301,159
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		1,003,037	191,249

“Ujësja Ura Vajguore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e ndryshimeve të Kapitalit gjatë Periudhës 1 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor 2014
ne nje pasqyre te pakonsoliduar

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione te thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2012	4,066,002	3,675,840	-	3,850,358	(883,602)	10,708,598
Efekt i ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-	-	-	-	-
Pozicioni i rregulluar	4,066,002	3,675,840	-	3,850,358	(883,602)	10,708,598
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	1,611,668	1,611,668
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve(pjeseve te reja te kapitalit)	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2013	4,066,002	3,675,840	-	3,850,358	728,067	12,320,267
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	(4,073,592)	(4,073,592)
Dividentët e paguar	-	-	-	-	0	0
Emetim i kapitalit aksionar (pjeseve te reja)	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	728,067	(728,067)	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2014	4,066,002	3,675,840	-	4,578,425	(4,073,592)	8,246,675

HARTUESI

PËR UJËSJELLËS SHA URA VAJGUORE

NIGJARE PAJO

ADMINISTRATORI

PETRE F SULA





Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-16

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2014

1. Informacione te pergjitheshme

"Ujësjetës Ura Vajgurore" sh.a është krijuar si shoqëri anonime me vendim të gjykatës së rrethit Gjyqsor Tirane nr.29588 date 22.04.2003. Kapitali i regjistruar i shoqërisë aktualisht është 4.066.002 leke i ndarë në 4.066 aksione me vlerë nominale 1000 leke për aksion dhe zotërohet 54.6% nga Bashkia Ura Vajgurore dhe 45,4% nga Komuna Poshnje. Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë është prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm i popullatës në bashkinë Ura Vajgurore dhe Komunën Poshnje.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë, banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shumë të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitetet të tjera të cilat nuk janë aktivitetet investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njësia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim, si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Paraqitja në bilancin kontabël koresponдон me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

Aktivitet financiar

Shoqëria i klasifikon aktivitetet financiare në Llogari/Kërkesa të arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Drejtimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivitetet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto, pakesuar nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kerkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësise për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënje vlerë të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur ekzistojnë rrethana që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare". Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen.

Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK-4 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra për ti sjelle inventaret në kushte magazinimi, kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri.

Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuar me vlerën neto, pra më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuar të shitjes.

Aktivitet afatgjatë materiale

Aktivitet afatgjatë materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta në zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk

amortizohen. Normat e perdorura jane ne ndertesa 5 % te vleres se mbetur dhe per aktivet e tjera 20% te vleres se mbetur.

Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar ne percaktimet e SKK-2.

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Llogaritë te pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huase.

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme ne marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2014 eshte 15 % nga 10% qe ka qene ne ushtrimin e mëparshëm. Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK-11 për tatimin e shtyrë.

3. Aktive monetare (likuiditete ne banke dhe arke)

Gjendjet e mjeteve monetare, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 jane si me poshte:

“Ujësjiellës Ura Vajgurore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2014		Gjendja ne 31.12.2013	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	leke	1,003,037		191,249	
Arka	leke	0		0	
Shuma Mjete monetare		1,003,037	0	191,249	x

Gjendjet e llogarive te mjeteve monetare te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare te bankave perkatese dhe inventaret fizike.

4. Aktive te tjera financiare afatshkurtera- Llogari/Kerkesa te arketueshme

Llogari/Kerkesa te arketushme jane te perbera si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Kliente per mallra, produkte e sherbime	8,813,380	10,905,557
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per mallra, prod.e sherb	0	0
Kliente per aktive afatgjata		
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per aktive afatgjata		
Shuma Kerkesa te arketueshme	8,813,380	10,905,557

“Kliente per mallra produkte e sherbime” pasqyrojne vleren e faturave te pa likujduara ne fund te ushtrimit.. Drejtimi vlereson se shumat e paraqitura ne llogarite individuale jane te arketueshme.

5. Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme

Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme jane te perbera si vijon :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Debitore kreditore te tjere	1,357,871	0
Shteti per tatime dhe taksa	381,756	471,358
Shteti-Tatim mbi fitimin (teprica debitore)	381,756	471,358
Shteti-TVSH per tu marre	0	0
Shteti Sigurime Shoqërore Shëndetsore(teprica debitore)	0	0
Personeli (teprica debitore)	54,109	30,161
Premtim pagesa të arkëtueshme		
Shuma	1,793,736	501,519

Drejtimi vlereson se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

“Ujësjiellës Ura Vajgurore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

6. Inventari

Inventari është i përbërë si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Lende të para		
Materiale të para dhe materiale të tjera	338,101	314,739
Inventari i imet dhe ambalazhi (afatshkurter)	75,931	73,881
Shuma Lende të Para	414,032	388,620
Prodhim në Proçes		
Punime në proçes	0	0
Sherbime në proçes		
Shuma Prodhim në Proçes	0	0
Produkte të Gatishme	0	0
Mallra për Rishitje	0	0
Parapagime për furnizime	0	0
Shuma inventar	414,032	388,620

Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër perputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në fund të ushtrimit 2014. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogaritë e rezultatit me mënyrën e inventarit të përhershëm. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda “FIFO”.

Drejtimi ka gjykuar se vlera e paraqitur është vlera me e ulët mes kostos së marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevojë për zhvlerësime të tij.

7. Aktive afatgjata materiale

Aktivët Afatgjata Materiale (AAM-te) përbëhen si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertime	Instalime teknike, makineri pajisje, etj.	Mjete transporti	Pajisje zyre e informatike	Totali
Kosto e AAM me 01.01.2014	3,675,840	42,938,349	11,868,582	2,189,000	646,018	61,317,789
Shtesat	0		18,300	0	0	18,300
Pakesimet	0				0	0
Kosto e AAM me 31.12.2014	3,675,840	42,938,349	11,886,882	2,189,000	646,018	61,336,089
Amortizimi AAM 01.01.2014	0	28,582,574	9,741,830	1,815,791	404,968	40,545,164
Amortizimi ushtrimor	0	717,789	425,350	74,642	48,210	1,265,991
Amortizimi për daljet AAM	0					0
Amortizimi i AAM me 31.12.2014	0	29,300,363	10,167,180	1,890,433	453,178	41,811,155
						0
Vlera neto e AAM 31.12.2013	3,675,840	14,355,775	2,126,752	373,209	241,050	20,772,625
						0
Vlera neto e AAM 31.12.2014	3,675,840	13,637,986	1,719,702	298,567	192,840	19,524,934

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të perputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit dhjetor 2014. Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur

“Ujësja e Ura Vajgurore” sh.a

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

modelin e kostos(SNK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi. Drejtimi ka gjykuar se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime. Metodot dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane lineare (shih shenimin nr.2). Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

8. Detyrimet afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Te pagueshme ndaj furnitoreve		
Furnitore per mallra, produkte e sherbime	19,846,540	13,867,116
Te pagueshme ndaj punonjesve		
Detyrime ndaj personelit per paga dhe shperblime	1,343,305	1,789,257
Shuma Te pagueshme ndaj punonjesve	1,343,305	1,789,257
Detyrime tatimore		
Detyrime per sigurime shoqerore shendetsore	620,899	255,110
Shteti per tatime e taksa		
Tatim mbi te ardhurat personale	12,395	61,605
Tatim mbi fitimin	0	0
Tvsh per tu paguar	157,933	271,065
Te tjera tatime per tu paguar	0	14,762
Tatim ne burim	27,105	167,005
Shuma Shteti per tatime e taksa	197,433	514,437
Shuma Detyrime Tatimore	818,332	769,547
Hua te tjera		
Debitore te tjere kreditore te tjere	1,294,268	1,482,356
Shuma hua te tjera	1,294,268	1,482,356
Shuma Huate dhe Parapagimet	23,302,445	17,908,276

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per çdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

“Të pagueshme ndaj punonjësve” perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2014. “Detyrimet per sigurime shoqerore e shendetsore” perfaqesojne detyrimin per sigurimet shoqerore e shendetsore te muajit dhjetor 2014. “Shteti per tatim taksa” pasqyrojne detyrimin per tatimin mbi vleren e shtuar, tatimin mbi te ardhurat personale me 31 Dhjetor 2014.

Ne “Hua te tjera” jane paraqitur detyrimet e shoqerise ndaj ERU dhe Agjensise se Basenit Ujor Fier.

9. Grantet dhe te Ardhurat e Shtyra(Afatgjata)

Grantet dhe te ardhurat e shtyra (afatgjata) perbehen si vijon:

“Ujësja e Ura Vajguore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Grante afatgjata	0	2,531,029
Interesa pasive të llogaritura		
Te ardhura të periudhave të ardhshme		
Shuma Grantet dhe të ardhurat e shtyra afatgjata	0	2,531,029

Grantet afatgjata përfaqësojnë vlerën e mbetur të AAM të mara falas.

10. Kapitalet e veta

Kapitali themeltar përbehet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Kaitali i paguar	4,066,002	4,066,002
Kapitali i nënshkruar i papaguar		
Shuma Kapitali themeltar	4,066,002	4,066,002

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në bilanc, është i njëjti me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKR. Me 31.12.2014 ai është 4.066.002 lekë.

11. Fitimi(humbja) e vitit financiar

11.1 Shitjet neto

Shitjet neto përbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Shitje e produkteve të gatshme	16,638,054	16,731,220
Shitja e punimeve dhe e shërbimeve	-	-
Shitje mallrash	-	-
Shuma Shitje neto	16,638,054	16,731,220

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja.

11.2 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit përbehen si vijon:

“Ujësjetës Ura Vajgurore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguse

Shumat shprehen në lekë

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga shitjet e tjera		
Gjoha, kamatvonesa	363,943	381,138
Te ardhura te tjera (shitje skrapi)	0	1,991,647
Te tjera	288,498	375,703
Shuma Te ardhura nga shitjet e tjera	652,441	2,748,488
Puna e kryer dhe e kapitalizuar	0	760,323
Te ardhura nga grantet subvecin diferenc cmimi	4,500,000	5,500,000
Te ardhura te tjera (Kuota pjese e granteve afatgjata)	2,531,029	2,500,000
Te ardhurat neto nga shitja e aktiveve		
Shuma Te ardhurat e tjera (nga veprimtarite e shfrytezimit)	7,683,470	11,508,811

11.3 Shpenzimet per Mallrat, lendet e para dhe sherbimet

Shpenzimet per Mallrat, lendet e para dhe sherbimet perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Blerje/Shpenzime te materialeve	2,210,553	3,481,212
Blerje/Shpenzime te materialeve te tjera	0	0
Blerje/Shpenzime mallrash e sherbimesh	0	0
Blerje/Shpenzime te tjera (Energji Elektrike)	8,719,675	4,187,938
Shuma Mallrat lendet e para dhe sherbimet	10,930,228	7,669,150

Konsumi i materialeve, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme dhe i perkasin ushtrimit 2014.

11.4 Shpenzime te personelit

Shpenzime te personelit perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Pagat dhe sherblimet e personelit	11,202,953	11,388,577
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	1,871,254	1,902,142
Kontribute dhe kuota te tjera per personelin	0	0
Shuma Shpenzime te personelit	13,074,207	13,290,719

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

11.5 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

“Ujësja e Ura Vajguore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënime shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Sherbime nga te trete		
Sherbime nga te trete	0	282,150
Qira	189,000	360,000
Mirembajtje riparime	170,400	226,900
Sigurime	41,820	0
Honorare	518,121	515,365
Shuma sherbim nga te trete	919,341	1,384,415
Sherbime te tjera		
Paga per keshillin mbikqyres	1,587,000	1,530,000
Te tjera	0	0
Personel jashte njesise	0	569,051
Reklame publicitet	0	0
Shpenzime per ERU	0	0
Udhetime e Dieta	81,600	83,000
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	38,278	22,995
Shpenzime per sherbimet bankare	5,150	5,500
Shpenzime ushqimi punonjeseve	1,700,400	1,795,400
Materiale kancelari etj	0	0
Shpenzime te tjera per personelin	0	0
Shuma Sherbime te tjera	3,412,428	4,005,946
Kuota e shpenzimeve per tu shpendare	0	0
Tatime dhe taksa		
Taksa dhe tarifa vendore	0	148,025
Tatime te tjera	0	0
Shuma Tatime dhe taksa	0	148,025
Gjoha demshperblime	449,262	15,880
Falja e debitorëve sipas ligjit mbi faljen e detyrimeve	0	0
Humbje nga rivleresimi/Shitja e aktiveve	0	0
Te ardhura nga shitja e aktiveve	0	0
Vlera kontabel Neto e mbetur e AAM	0	0
Shuma shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	4,781,031	5,554,266

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjisruar me shumen e paguar ose te pagueshme.

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.

“Gjoha e demshperblime” perfaqesojne detyrimet dhe saksionet tatimore te rezultuara nga njoftim vleresimet e vitit 2014. Ato jane rimarre ne fitimin tatimor, shenimi Nr.11.7.

11.6 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

“Ujësjetës Ura Vajgurore” sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguse

Shumat shprehen në lekë

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare janë paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet financiare:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat		
Te ardhurat nga interesat	0	15,104
Shpenzime per interesa	0	0
Shuma te ardhura dhe shpenzime nga intersat	0	15,104
Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit		
Fitim nga kembimet valutore	0	0
Humbje nga kembimet valutore	0	0
Shuma Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit	0	0
Rimarrje e zhvleresimit te klienteve	0	0
Te ardhura te tjera financiare	1,658,391	1,200,000
Shuma e ardhurat dhe shpenzimet financiare	1,215,104	25,799

11.7 Shpenzimet e Tatim fitimit

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2014 dhe 2013 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
I FITIMI (HUMBJA) NETO PARA TATIMT	(4,073,592)	1,792,507
II SHPENZIME TE PA ZBRITESHME (+)	449,262	15,880
1. Amortizimi tej normave fiskale		
2. Shpenzime per pritje e dhurime tej kufirit tatimor		
3. Gjoha, penalitete, demshperblime	449,262	15,880
4. Provizione qe nuk njihen		
5. Shpenzime pa dokumenta te rregullta		
6. Te tjera	0	0
III PJESA E HUMBJES SE MBARTUR (-)		
IV FITIM (HUMBJA) TATIMORE (I+II-III)	(3,624,330)	1,808,387
V SHPENZIMET E TATIMIT MBI FITIMIN		180,839
VI FITIMI(HUMBJA) NETO E USHTRIMIT	(4,073,592)	1,611,668

12. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, ne 31 dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

"Ujësjetllës Ura Vajguore" sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguse

Shumat shprehen në lekë

13. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk eshte evidentuar ndërmjet datës së bilancit dhe datës kur janë miratuar nga drejtimi keto pasqyra financiare, si per ngjarjet që mund te ekzistonin në datën e bilancit dhe per ato që japin të dhëna pas datës së bilancit.

Pasqyrat financiare jane hartuar sipas parimit te vijimesise.

Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare, rezulton se ne ushtrimin 2014 shoqeria ka dale me humbje ne shumen 4.073.592 leke.

14. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2013 jane te njejta me ato te prezantuar ne vitin aktual 2014.

HARTUESI

PËR UJËSJELLËS SHA URA VAJGUORE

NIGJARE PAJO

ADMINISTRATORI

PETREF SULA

